

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“SEASIDE RESIDENCE V” SH.P.K.**

Sot më datë, 17.02.2021, pala e mëposhtme,

**GREEN COAST Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, përfaqësuar nga administratori Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur më 24.04.1973, në Laç, Krujë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE7466969, dhe me nr. personal H35424057N

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "**Seaside Residence V**" **Sh.p.k.**. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtoja A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

**Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Œshtë themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**Seaside Residence V**" **Sh.p.k.** (këtej e tutje referuar edhe si "**Shoqëria**").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rr "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
  - a. Projektim dhe ndërtim i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë;
  - b. Veprimtari ekonomike në fushë e turizmit, nëpërmjet ngritisës, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar;



- c. Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.;
- d. Shitja e objekteve / njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira;
- e. Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj.
- f. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000 LEK (një mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1,000 LEK (një mijë lekë) secila.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
  - Green Coast Sh.p.k., ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 1,000 LEK (një mijë lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
  - Green Coast Sh.p.k. zoteron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

#### **Neni 6 – Transferimi i Kuotave**

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

#### **Neni 7 – Administratori/ët**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përvçe kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nësë Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përparrë mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushton të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
  - Znj. Dafina Keçi, shtetase shqiptare, e lindur më 31.05.1985 në Bajram Curri, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 033740933, dhe me numër personal I55531071U.



### Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\* \* \*

**NË DËSHMI TË SA MË SIPËR,** Pala deklaron se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsy e nënshkruan atë në datën e sipërshënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

Green Coast Sh.p.k.



## **ANEKSI A**

### **STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SEASIDE RESIDENCE V” SH.P.K.**

#### **KAPITULLI I EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI**

##### **Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.3. Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Seaside Residence V” Sh.p.k” (këtë e tutje referuar edhe si “Shoqëria”).
- 1.4. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

##### **Neni 2 - Selia**

- 2.3. Selia e Shoqërisë është në Rr “Dervish Hima”, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, Shqipëri.
- 2.4. Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

##### **Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.3. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.4. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

##### **Neni 4 – Objekti**

- 4.1. Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
  - a. Projektim dhe ndërtim i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre përvete dhe përtë tretë;
  - b. Veprimtari ekonomike në fushë e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkontëtar;
  - c. Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.;
  - d. Shitja e objekteve / njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira;
  - e. Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj.
  - f. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme përritjen

dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR, RRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.3 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,000 LEK (një mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1,000 LEK (një mijë lekë).
- 5.4 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
  - Green Coast Sh.p.k., ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 1,000 LEK (një mijë lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
  - Green Coast Sh.p.k. zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

#### Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.2 Kapitali nuk mund të zmadhohet për sa kohë nuk është përmbushur detyrimi për të paguar kuotat e nënshkruara më parë nga Ortaku i Vetëm.

#### Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga Ortaku i Vetëm në të njëjtën masë me pjesën e kapitalit të zotëruar prej tij.

#### Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 8.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përvçese kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

## KAPITULLI III

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

#### Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 9.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimin e shkarkimin e Administratorëve, ekspertëve kontabël e likuiduesve, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, transferimin e kuotave, riinvestimin e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, miratimin e bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe legjisacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë apo nga ky Statut

#### **Neni 10 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 10.1 Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 10.2 Ortaku i Vetëm ka të drejtë të përfaqësohet nga një person i pajisur me prokurë me shkrim, i cili nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një ortak tjetër. Në çdo rast, prokura mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 10.3 Ortaku i Vetëm nuk mund të autorizojë asnjë përfaqësues për të votuar për një pjesë të kuotave që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë, ndërsa voton personalisht për pjesën e mbetur të tyre.

#### **Neni 11 – Thirja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e viti financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratorit/ëve, si dhe raportin e ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 11.2 Asambleja Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose nga Ortaku i Vetëm. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje apo mesazh elektronik me evidencë marrje, dërguar ortakëve – në adresën që rezulton në Regjistrin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara mbledhjes. Thirja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë së Përgjithshme, rendin e ditës, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 11.3 Asambleja Përgjithshme mund të mblidhet edhe në një vend tjetër të ndryshëm nga selia e Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit.
- 11.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 11.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërisht brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 11.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet audio apo video-konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga Kryetari dhe kanë mundësinë të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të; pasi të janë verifikuar këto kërkesa që duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.



- 11.6 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e thirrur dhe zhvilluar rregullisht edhe pa respektimin e formalitetave të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar dhe të gjithë ortakët janë dakord të vijojnë me mbledhjen pavarësisht parregullsive të njoftimit.
- 11.7 Ortaku i Vetëm mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 11.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Ortaku i Vetëm apo përfaqësuesi i tij i autorizuar. Asambleja e Përgjithshme emëron një sekretar për të mbajtur procesverbalet. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen bashkarisht nga Kryetari dhe sekretari.

#### **Neni 12 – Administratori/ët**

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht përvçe kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpëra mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovalitet automatikisht edhe për një vit tjeter.
- 12.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.

#### **Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 13.1 Nëse është e nevojshme/kërkohet nga ligji ose vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë kryehet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni përkatës.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor**

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin vjetor, pasqyrat financiare, inventarin, raportet e Administratorit/ëve dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 14.4 Dokumenta që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e viti financiar.

### **Neni 15 – Fitimet**

- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor përdoren në përputhje me vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme ose të shtyjë ri-investimin e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.
- 15.2 Fitimet do të përdoren në përputhje me Objektin e Shoqërisë përcaktuar në Nenin 4 të këtij Statuti dhe në veçanti në përputhje me parimet dhe praktikat e biznesit social të treguar në Nenin 4.3.

### **KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI**

#### **Neni 16 – Shpërndarja**

- 16.1 Shoqëria mund të prishet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme apo në rastet e parashikuara nga ligji.
- 16.2 Shoqëria nuk prishet për shkak të paaftësisë për të vepruar, pengesave ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

#### **Neni 17 – Likuidimi**

- 17.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidues të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme të likuidimit.
- 17.3 Në fund të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit, si dhe riinvestimin në biznese sociale të shumave eventualisht të mbetur pas likuidimit të cilat tejkalojnë kapitalin që ortakët kanë investuar, duke përcaktuar modelitet e nevojshme për këtë qëllim.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të maturuara, likuiduesi/t u shpërndajnë ortakëve asetet e mbetur në përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme marrë në bazë të nenit 17.3 më sipër.

### **KAPITULLI VI TË NDRYSHME**

#### **Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore nga palët e interesuara.

- 18.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo i paraqitet Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përveç kur ndonjë prej ortakëve vendos t'i ia nënshtronë zgjidhjen e mosmarrëveshjes një Gjykate Arbitrazhi.
- 18.3 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi e Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Tiranë më 17.02.2021

**ORTAK I VETËM I SHOQËRISE “ SEASIDE RESIDENCE V”SH.P.K.**

Z. Celjeta Apostol  
Green Coast Sh.p.k.  
*Përfaqësuar ligjërisht nga Z. Celjeta Apostol*



Green Coast  
L41329038D